

VENDIM
Nr.52, datë 27.1.2006

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ÇMIMEVE
TË BARNAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 e 51 të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Çmimeve të Barnave, pranë Ministrisë së Shëndetësisë, të përbërë nga kryetari dhe 8 anëtarë, përfaqësues të:

-Ministrisë së Shëndetësisë	kryetari dhe 2 anëtarë
-Ministrisë së Financave	1 anëtar
-Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	1 anëtar
- Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor	2 anëtarë
- Urdhrit të Farmacistëve	1 anëtar
- Shoqatës së Pacientëve të Shqipërisë	1 anëtar.

2. Drejtoria Farmaceutike, në Ministrinë e Shëndetësisë, brenda muajit dhjetor të çdo viti, të paraqesë pranë Komisionit të Çmimeve të Barnave, të dhëna për çmimet e barnave, të fabrikua në vend dhe për ato të importuara.

3. Komisioni i Çmimeve të Barnave të kryejë procesin e negociimit me fabrikuesit, vendas e të huaj, e me përfaqësitë farmaceutike në vendin tonë, të hartojë listën e përgjithshme të çmimeve të barnave të regjistruara dhe t’ia paraqesë Ministrit të Shëndetësisë, i cili e propozon për miratim në Këshillin e Ministrave, brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik.

4. Çdo anëtar i Komisionit të Çmimeve të Barnave të shpërblehet me 5 000 (pesë mijë) lekë për pjesëmarrje në mbledhje, por masa e shpërblimit mujor nuk duhet të jetë më shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë.

6. Vendimi nr.241, datë 18.5.2000 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha